

VENDIM
Nr.1060, datë 31.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.988, DATË 1.12.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.988, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave, dispozita e hyrjes në fuqi ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 2011.”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha